

Universiteti I Prishtinës “Hasan Prishtina” – Fakulteti Juridik

Niveli Master – Drejtimi Kushtetues Administrativ

Kandidati : Violeta Sadiku Zeka

Mentori: Prof. Dr. Arsim Bajrami

Tema: Funkcionet kushtetuese të Kuvendit me vështrim të veçantë kontrolli parlamentar''

Punimin e temës e kam përqëndruar në Kuvendin e Republikës së Kosovës , si degë legjislative që është institucioni më i rëndësishëm në vendin tonë, ngase në kuadër të politikëbërjes duke u bazuar në parimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë zbaton politika publike duke aprovuar ligje dhe duke amandamentuar ligje, duke ratifikuar marrëveshjet ndërkombëtare vendime në interes të përgjithshëm, votimin e Presidentit, Qeverisë dhe Kryeministrit, Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, dhe krejt këto votime bëhen nga deputetët e subjekteve politike që kanë fituar mandatin nga rezultatet e zgjedhjeve të mbajtura për nivelin qendror.

Në këtë punim kam analizuar funksionimin e Kuvendit institucionit më të lartë vendimmarrës, gjithashtu kam analizuar edhe përbërjen e tij, funksionimin e grupeve punuese të përhershme parlamentare, grupet parlamentare, Kryesinë e Kuvendit, Kryetari i Kuvendit, Shefat e Grupeve Parlamentare, procedurat e shqyrtimit të një ligji nga propozimi që vije nga Qeveria e deri te aprovimi i tij në Kuvend, duke përfshirë edhe grupet punuese. Gjatë punimit tim kam shqyrtuar edhe rolin dhe bashkëpunimin e pozitës dhe opozitës në hartimin dhe aprovimin e ligjeve, debatet në kuvend, dhe konstruktivitetin në dhënjën e kontributit të deputetëve në kuvend.

Sa i përket pjesës së përgjithshme kam hulumtuar lidhur me atë, se si Kushtetuta i ka dhënë kompetencë Kuvendit për funksionimin e tij dhe roli që ka në procesin e politikëbërjes, duke e bërë rregullues dhe aprovues të çdo nisme juridike institucionale për aprovimin e ligjeve. Përpos aprovimit të ligjeve, në punimin tim fokus të veçantë i kam dhënë edhe rolit të Kuvendit në aspektin e politikëbërjes në Republikën e Kosovës ku përmes deputetëve dhe Kryetarit të Kuvendit do të paraqiten qëndrimet e institucionit karshi vendimeve të marrura nga Kuvendi. Puna ekipore në grupet punuese është pjesë e fokusit në punimin tim, ngase vlerësojë se një shqyrtim profesional nga grupet punuese në Kuvend dhe një diskutim përmbajtësor nga grupet politike parlamentare që veprojnë në Kuvend do të sjellin një ligj përmbajtësor dhe të zbatueshëm.

Sa i përket pjesës së veçantë jam fokusuar tek rastet konkrete prej momentin që vije një draftligj nga Qeveria, fillimi i procedurave të shqyrtimit të tij në komisionet punuese, duke përfshirë edhe aprovimin e tij në Kuvend. Gjithashtu kam shqyrtuar edhe rolin e Kryetarit të Kuvendit në aspektin e politikëbërjes në vend rolin e tij, në punim do të përfshijmë edhe rendësinë e bërjes opozitarizëm opozitën si një vlerë e çmuar e demokracisë parlamentare, metodat dhe format që i përdorë opozita për ta kontrolluar qeverinë, mandej grupet parlamentare, komisionet punuese. Ajo çka ishte fokus i punimit tim ishte procedura prej inicimit deri në votimin e një projektligji.